

VENDIM
Nr. 38, datë 6.8.2025

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR LICENCIMIN E DEGËS SË
BANKËS SË HUAJ NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË “DEGA E BANKËS TURKIYE
CUMHURIYETI ZIRAAT BANKASI A.S., ALBANIA”**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “e” të nenit 43 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të pikave 1 dhe 2 të nenit 19 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar; të pikës 1 të Shtojcës nr. 1 të rregullores “Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare”, miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës, e ndryshuar; dhe me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për licencimin e degës së bankës së huaj në Republikën e Shqipërisë “Dega e Bankës Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankası A.S., Albania”.
 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
 3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gent Sejko